

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

DJH-1  
v74

**PIRRO VISARI**

**Rrugët  
nuk flenë**


**vjersha**

SH-1

174.

**PIRRO VISARI**

**Rrugët  
nuk flenë**



**vjersha**

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## DITËN QË MBUSHA 20 VJET

Isha me shërbim ditën që mbusha 20 vjet  
dhe në vend të 30 gotave të mbushura me verë,  
dhe në vend të 30 urimeve të bujshme,  
në karikatoren e automatikut,  
rrinin të heshtur  
30 fishekë.

Isha me shërbim ditën që mbusha 20 vjet,  
e i pa gjumë ruaja gjumin e shokëve,  
dhe oshëtinin hapat në natën e qetë,  
dhe oshëtimi sillte urimet e largëta  
të nësës, vëllait, së dashurës:  
— U bëfsh 100 vjet!

Atë natë të ngrirë si kristal,  
unë mund të mbaja në qafë kitarën time,

e me të të sillja ndër mend,  
vegimet e viteve që shkuan.

Megjithatë, ai qe më i bukuri përvjetor ditëlindjeje...

...Në qafë varej automatiku i rreptë  
dhe kupa e qiellit pikonte yje mbi mua:  
– Për shumë vjet gëzuar!

## NË MUZEUMIN E MP BRËNDËSHME

*Në stendat e këtij muzeumi  
ndodhet libri i një prifti  
me një pistoletë mes fletëve.*

Pse çuditësh?  
Kurdoherë pas mjegullës së frazave latine,  
pas erës së këndshme të temjanit,  
kurdoherë prapa ikonave e psallmeve  
qafën çonin  
tytat e armëve...

DUKE VËSHTRUAR TELAT E TENSIONIT  
TË LARTË NË VERI

Male dhe male!

Male që janë mësuar të mbajnë mbi shpatulla  
gjithmonë diçka:  
varre betejash, zana mbuluar me ferexhe,  
kulla të vetmuara me kokën në re,  
kushtrime të thekshme me pëllëmbën tek veshi,  
dëborë të virgjër mbi krye si qeleshe.

Shtrihen tani në shpatullat e tyre të mprehta,  
telat e tensionit të lartë në qindra kilometra.

Dhe të ngjajnë tani malet,  
si ca çifteli vigane.  
S'janë këngë tragjike mermëritjet e tyre,

për krisma hakmarrjesh, daullesh me nerva.  
Në këto tela  
shoqërohet kënga e fuqishme e dritës,  
e dritës në jetë,  
e dritës në kulla,  
e dritës në zemra...

## VEZULLIME MBI METAL

Shiu rrjedh pareshtur nën xhaketë,  
i ftohtë.

Shiu lag këmishën dhe kraharorin e nxehtë.

Nga larg, përmes mjegullës së tij,  
vijne vizionet e shtrenjta  
rrudhat e nënës tek pragu i shtëpisë,  
ku në secilën rri ulur një vit i fëmijnisë  
profili i motrës përkulur mbi fletore.  
Këto vizione më të buta se floku i borës,  
më të ngrohta se ngrohtësia e dhomës.  
Por, ashpërsohet shikimi,  
tendoset fytyra,  
përpara mjegullës së shiut  
ndodhet  
detyra...



...Shiu rrjedh pareshtur nën xhaketë,  
mbi xhaketë metali shkëlqen ndër piklime.  
Ndodhen larg  
konturet e qytetit të lindjes.  
Atje është një kitarë e magjishme,  
(Me kitarë i kam përcjellë dikur vitet...)  
një stol i bardhë nën muzgun ngjyrë jargavan  
dhe një zemër që pret me mall.  
Por ashpërsohet shikimi,  
tendoset fytyra,  
përmes shënjestrës së armës  
duket  
detyra...

## KUR KTHEHESHIM PREJ PRITËS

*Nga kujtimet e një veterani të  
organeve të sigurimit.*

Ktheheshim prej pritës.  
Në rroba akoma baltë e ngjitur,  
në rroba si qëndismë gjaku i piksur.  
Qimet në mjekër  
shponin si bizë.

Ktheheshim prej pritës  
me fytet e gërvishura  
nga dhëmbë banditësh.  
Me javë dhe muaj  
larg shtëpisë.

Dhe kur tek pragu  
doçkat të hidhte djali,  
një lot mund që s'mbahej  
rridhte faqes tatëpjetë.

(Malet e rëndë dhe të sertë,  
që gjoksin zbërthejnë përpara rrufesh,  
bëhen tepër të ndijshëm,  
kur mbi shpatulla  
mbajnë hënën fytyrëzbetë dhe të brishtë...)

## HERONJTË

Dikush ra i përgjakur në ballë,  
dikush nër dallgë  
u ngrit si dallgë e u këput si dallgë.  
Dikush mes flakësh  
u drodh si flaka  
e me flakë shkroi diçka.

Por askush nuk mendoi në çastin e fundit  
se për të do thurnin poema,  
se pionierët mbi varr do t'i sillnin lule,  
se netëve pleqtë do t'i këndonin me iso,  
se emrin e tij do t'ia jepnin një rrugë.

Jo! Këto s'i menduan kurrë!  
(Heroizmi, si burimi, rrjedh pa bujë...)

## AI MBETI NË KËNGË

I pëlqente kënga e shtruar plot mall,  
ku në çdo notë dridhej zemra e zhuritur,  
ku ndihej zhurma e valës në zall,  
rënkimi i heshtur i një jete të drobitur.

Këndonte mbi brazdat që mbillte me djersë,  
për ditët pa bukë, për netët pa gjumë;  
për gjethet e njoma mbuluar me vesë,  
për diellin që lahej mëngjesit në lumë

Dhe rridhte kënga e vetmuar çdo natë,  
dhe malet e fushat me të hallet i qanë,  
dhe ngrihej mbi hallet një këngë e zjarrtë:  
— Po mbushen malet me partizanë...

...Braktisi parmendën, këngët tek lumi,  
dhe malit doli me pushkën në krah,  
fishkëllenin tek veshët era dhe plumbi,  
urrejtja popullore shpërthente vullkan.

Malet dhe grykat larg i shpinin këngët,  
këndoi ai për jetën e ndritur,  
plumbi fashist e goditi në zemër,  
por s'mbeti në mes kënga e nisur...

...I pëlqente kënga e shtruar plot mall,  
për gjethet e njoma mbuluar me vesë,  
për diellin që nesër do ish më i madh,  
për fëmijën që nesër i lumtur do qeshej.

Dhe fshatarët e tij, që e deshën aq shumë,  
kënduan për të në netët me hënë,  
dëgjonte vala e nemitur mbi lumë:  
— Ai mbeti përjetësisht në këngë...

## ELEGJI PËR LIRI GERON

Dy gërshetat thurur,  
hedhur përmbi gji,  
në gushën e bukur  
lidhur një shami.

Mbi shtatin e njomë,  
shtrirë si zambaku,  
benzinë të hodhën,  
flaka porsi gjaku.

Plumbat rrotull binin,  
si lotë të nxehtë,  
flaka mbi shaminë,  
puthte sy e vetull.

Malet ulën kokën,  
s'mund të qanin dot,  
avull nxirrte toka,  
Liri Gero moj!

Malet ulën supet,  
dhe të mbajtën varg,  
kur s'u duket rruga  
digjesh ti pishtar.



## POPULLI YNË

Populli:

— Një mal ku armiqtë  
vërsulen si dallgë  
dhe rrokullisen përdhe  
si gurë.

Një mal që forcon bazën rrënjët  
dhe mpreh majën në furtunë.


Populli:

— Një mal që zbërthen gjoksin në kohë të  
vështira,

që këmbët ka në tokë,  
kokën në kaltërsira.

Maja e tij:

— PARTIA



## M E D I T I M

Ndërtojmë dhe vitet na shkojnë vepër më vepër  
por dhe roje bëjmë tek kufijtë në zheg e furtunë.  
Përkëdhelim fëmijët, luajmë miturisht me ta  
dhe supet na lehtësohen nga pesha e ditës dhe e punës.  
Projektojmë linja të reja e lexojmë në orët e vona të  
natës,  
letërsi, biologji e matematikë.

Jetojmë, pra, në mënyrë të vrullshme,  
pa patur kohë të vërejmë,  
pa patur kohë të mendojmë,  
si thinjemi.

Dhe kur befas, një çast,  
shikojmë thinjat e para,  
pemzën e rrudhave anash syve,  
biem në mendime...

Por s'janë mendimet tona  
një pus i thellë ekzistencialist  
ku hidhesh dhe s'del dot më kurrë.

Ne vërtet mendoheми,  
por jo se kemi frikë nga vdekja,  
por se sa i dhamë atdheut  
e sa mund t'i japim  
nga jeta...

## SHIKOJE, LINDA!

Shikoje, Linda, dhe mos u skuq!  
Ai djalosh i hijshëm  
me atë trup të derdhur e sy të butë,  
është bir i një të pushkatuari  
nga dora e popullit, dikur.

Shikoje, Linda, drejt në sy!  
Njëherë dhe më kurrë!  
Që të mos shpresojë për vështirime me bisht të syrit,  
për netë dashurie mos ëndërrojë  
dhe për klithma gërnetash, piskama violinash  
që do përshëndesin dasmën e tij.  
Që të mos shpresojë në kryqëzimin dhe zbutjen e  
racës.

Ai,  
mbetet bir i armikut të klasës.

Është ai që kuptimin e të atit e bëri idhull  
e në zemër i ngriti një pedestal madhështor.  
Është ai që merret me sportin e dashuriçkave të  
vogla!

Është ai që po mori fuqinë në dorë,  
rrëzë mureve na derdh,  
tru dhe zorrë.

Shikoje, Linda, drejt në sy,  
njëherë dhe më kurrë!  
Se tigrat e sotëm,  
prej qengji e kanë lëkurën...

## NA ISHTE DIKUR...

Kjo ndërtesë e bukur këtu lart në kodër,  
ishte vendi ku prifti tundte temjanicën,  
Dhe këto akacie plot erë rreth e rrotull,  
nxiheshin prej hijes së mureve të kishës.

Tymi i fjalëve mbështillte trurin dhe zemrën  
me cipën e turbullt të bindjes, injorancës  
dhe duart në vend që të mblidheshin grusht përpyetë  
shtriheshin tragjikisht drejt qiellit të zbrazët.

...Akaciet çelin sa herë vjen pranvera  
dhe ndërtesa ngrihet sërish mbi lulet e tyre.  
Por në vend të ramos duket bluza e bufetierit,  
prapa ekspresit që psherëtin dhe shfryhet.

Dy pleq pijnë kafe e luajnë domino,  
atje ku faleshin të devotshëm më parë  
dhe një çift të fejuarish kokë më kokë,  
qeshin duke ngrënë një pastë.

...Jo! Kjo s'është përrallë!

## STËRLINA E SHPUAR

Për zemrën që shiti, për tradhtinë,  
i dhanë një grusht stërlinash angleze,  
automatik «Tomson», thikë në çizme,  
60 metro mëndafsh, (qefinin me vete...)

...Parashuta binte si gjethi në vjeshtë,  
rrëshqiste si hije mbi kodra, lugina.  
Atij i dukej sikur zhurmëronte krejt  
qielli i mbushur me zhurmë stërlinash...

\* \* \*

Plaku i vjetër qelshen e bardhë  
e la t'i shkiste mbi zverkun me djersë,  
kondakun e pushkës mbështeti në faqe:  
— Nderomë dhe sonte, virane e shkretë!



Buçiti arma në natën e errët,  
kodrat e kthyen gëzueshëm oshëtimën,  
por plumbi i sertë më parë se zemrën,  
kish shpuar përmes të verdhën stërlinë...

## POLEMIKË ME DIKË

Ti më the duke përtypur fjalët si karamele:  
— Vërejtja, vëlla, është si puna e gozhdës  
edhe kur e heqin,  
vrina në mur mbetet...

...Unë mezi munda të dalloj,  
pas atij zjarri fjalësh,  
një tym të lehtë meskiniteti mikroborgjez.

Vërtet, shoku shef!  
Partia, kur gabojmë, na qorton rëndë,  
por kjo është një krasitje  
që të harlisen majat  
dhe të forcohen rrënjët..

## NJË TURIST

Në duart ka ai aparat të shtrenjtë,  
mbi kokën e thinjur kapele republikë.  
(Dikur mbi kokë mbante helmetë,  
në duart mizore mbante mashinkë...)

Këpucët pasqyrë të therin vështrimin  
e shkelin ngadalë asfalteve tona.  
( Dëgjoni kalldrëmet si japin kushtrimin!  
Gozhdët kalldrëmeve gjëmojnë akoma.)

Në xhepa tunden bllloqet me çeqe,  
(dikur në xhepa lista ilegalësh)  
tranzistori përhap muzikë xhezi,  
(altoparlantët ndër pushkatime hapeshin.)

Sërish ka ardhur turist i veshur,  
në tokën që desh ta kish nën thundër,  
me emër të ri mbi emrin e vjetër,  
i quajtur nga ne shkurt: «Spiun!»

...Merimangë e vjetër, ç'të shkon ndër mend?  
Cerga jote askund s'do qëndrojë  
se dhe një përpëlitje të syrit tënd  
me mijëra sy e fotorafojnë...

## UDHËT TONA S'JANË PARALELE

Ty të tremb mendimi se një ditë  
do «braktisësh» Tiranën plot drita,  
bulevardet e gjera pasqyrë,  
xhamat e mëdhenj të Pallatit të Kulturës.

Si mundet ta lesh ti  
soditjen e sheshit «Skënderbe»,  
zhytur në kolltukët e butë  
ndërsa shiu dritaret godet  
e ujin anash e hedh një veturë?

Dhe në imagjinatën e sëmure  
do ngrihen atëherë të ndritura,  
bulevardet e gjera pasqyrë,  
xhamat e mëdhenj të Pallatit të Kulturës,  
i zhurmshmi shesh «Skënderbe»

gjurmët e holla të veturës në asfalt,  
nën flokët e shiut të murmë.

Por keq s'më vjen aspak.  
Edhe unë s'do desha të kisha bashkudhëtar  
një lule që vyshket shpejt,  
në rrugën e gjatë dhe të vështirë të jetës.

Jam krenar që rininë time  
e gjej tek rinia e revolucionit  
dhe për këto fjalë  
zëri dhe zemra s'më dridhen kurrë!

...Udhët tona s'janë paralele.

## COPA E BUKËS

Buzë mezhdës me bar u ul sekretari  
dhe thjesht hapi bukën e mbështjellë me letër  
i uritur ish nga bredhjet nëpër ara,  
me ballin e njomur nga vesa e djersës.

Zbardhonin fushës tutje lahuritë e grave,  
~~tako~~ merrte frymë thellë,  
rrapëllima e traktorit në ajër përhapej  
ndërsa sekretari i partisë hante bukën.

Dhe copën e vogël që mbeti prej drekës,  
një copë që aspak e madhe nuk ish,  
e futi në xhep mbështjellë me gazetë  
dhe shtigjet nëpër ara mori sërish.

Veç zogjtë e panë kur përtypej ngadalë,  
veç zogjtë fluturuan kur u ngrit në këmbë,  
dhe s'ish ndonjë copë buke e madhe  
por ish dashuria e madhe, dashuri e rëndë...

## N A G A N T I

Kujtim nga im atë,  
naganti me mulli.  
naganti me shtatë,  
vështron me syn' e zi,

E marr në dorën time,  
rëndon sa përjetësia,  
dhe bie në mendime,  
buçet historia...

Tregon për ankthe pritash,  
kur zemra ndizej flakë,  
për çaste të vështira,  
gushbukuri si zambakë.



Seç foli atentatesh,  
me rrokje të metalta,  
gjuha e tij e prerë:  
— Fjalimet më të zjarrita...

Dhe në ndodhtë vitesh  
armiku të sulmojë,  
nagantit s'do t'i rrihet,  
etur do vështrojë.

Do e marr betejash,  
nagantin e rëndë,  
armikut për t'i derdhur,  
plumbat nëpër dhëmbë.

Dhe e di se gjallë  
do të dal prej luftës,  
nagantin fitimtar,  
do ta puth në gushë.

Dhe e di se prapë,  
do ta mbajë im bir,  
nagantin me shtatë,  
nagantin me mulli...

## 6 VARGJE NGA NJË POEMË PËR BUOKRACINË

Të fortat duar ngritën punëtorët,  
për djalin e një shoku të bëhesh drejtor.

Por shpejt ai harroi kujt klase i përkiste,  
mbi shpatullat e tyre deshi që të rrinte...

Detyrë tjetër mori, një vend me rëndësi,  
të nxirrte mineralin atje në galeri...

## KËNGË E VJETËR KORÇARE PËR KURBETIN DHE DASHURINË

Me kitarë natën të këndonin tek dera,  
— Hape dritaren se lehtë po fryn era...

Por ti s'dilje dot, s'të linte mamaja,  
dritares në rrugë, qante kitara.

Çarçafi i bardhë nën dritën e hënës,  
nata pa gjumë nga rrahjet e zemrës...

Dhe priti çapkëni me muaj dhe mote,  
por dallga e jetës e nisi në botë.

U vyshke dhe ti, prej mallit u thave,  
si lulet e tua atje në dritare.

Në netët e vjeshtës fryn era e marrë,  
të duket sikur këndon një kitarë.

Me vrull hap dritaren, çarçafin zhubros era,  
në rrugën e shkretë veç gjethet e verdha.

.....

Ku humbi kitara, çapkëni i mjerë?  
...E tret dhe i huai nën yje të tjerë...

## POEZIA E VËRTETË

Bisedonim për poezinë.

Në syzat e zeza miope të shokut tim,  
rrëshqisnin të dobta vezullimet  
e makinave që kalonin anash me shpejtësi.

Ndërkohë drejt nesh  
po vinte një vajzë si ëndërr e bukur,  
një vajzë që kthehej prej punës në fermë  
hipur mbi biçikletë.  
Pantallonat me baltë  
përveshur mbi pulpët e zeshkëta.

— Ja poezia e vërtetë!  
thamë të dy njëherësh...

...Pranë nesh kaloi një vajzë me biçikletë.

## ARMIKU I KLASËS

Përpara meje ndodhet armiku i klasës,  
bërë urë dhe përkulur si pikëpyetje  
dhe çdo pyetjeje që i bëhet, me servilizëm,  
me një: «Zoti hetues» — i pëngjigjet...

Zotërinjtë e dikurshëm të fateve tona  
akoma s'e kanë harruar fjalën «zotni»,  
akoma për atë fjalë ata ëndërrojnë,  
ndaj dhe fjalës së vjetër i japin kumbim të ri.

Ndërsa unë e pyes ai sheh përjashta,  
përtej dritareve që lahen prej lotëve të shiut,  
dhe në sytë e turbullt, amorfë si nata,  
pikat e shiut shndërrohen në pika të përgjakura...

Përpara meje ndodhet armiku i klasës,  
i urryeri dhe i munduri përjetë,  
mbi ëndrrat e marra për të vjetrën parajsë  
pezull rri e diktaturës shpatë e mprehtë...

## MEDITIM RRETH EMRIT «DIELLA»

Kaq shumë e deshën diellin  
malësorët nëpër kulla!  
Ndonëse mezi u futej  
ndonjë rreze e vetmuar.

Prej frëngjive shihnin qiellin  
vetëm me syrin e pushkës,  
por fëmijëve të tyre  
emrat iau dhanë të bukur.

Se fëmijët do të ishin,  
diej të së nesërmes!

## KËSHTJELLA E KRUIJËS

Para mureve të kështjellës së Krujës,  
ku dikur dyndeshin hordhitë,  
kanë mbetur shkëmbinj dhe gurë,  
si koka të prera prej turqish.

Shkëmbinjve ka mbirë bari i njomë,  
që dridhet nën fjalët e erës,  
dhe netëve del drapri i hënës,  
mirazh i një nostalgjie të egër...

...Sa herë i ngritën sytë në qiell  
tek hëna e ngrënë, e verdhë!  
Sa herë i ulën me turp përdhe  
ku e panë nën këmbë të shkelur!

Përjetësisht nën mure mbetën si gurë,  
tani liria shëtiti në kështjellë:  
Dhe netëve si tallje e hidhur, e shurdhër,  
del drapri i hënës, i ngrënë, i verdhë...



## PËRTEJ URËS SË QABESË

Mbi një lumë të tharë e pa emër  
ngrihej një urë e shkatërruar,  
vapa të pikonte hidhur në zemër,  
këndonte tej gjinkalla e trishtuar,

Ku zvarriten kështu këta njerëz kokulur?  
Shkretëtira pa fund, pa anë,  
rëra mën këmbë e verdhë si qelb plage,  
malli për vendlindjen eshtrat i çan.

Ku zvarriten kështu këta njerëz kokulur?  
Në fund të rreshtave një djalosh 18-vjeçar.  
Faqja e njomë si fletë trëndafili,  
si eshkë nga dielli është tharë.

... Rëra rrëshqiti nën këmbët e tij,  
dielli u vërtit me shpejtësi kolosale,  
shkretëtira egër e rrëmbeu në gji,

britma e tij mornica u ngriti maleve:

— Eeeej!

Mbeçë, shokë, mbeçë!

...Përpara —

shkretëtira pa anë

Mbrapa —

Ura e shkatërruar e Qabesë.

...Mes dritës së fortë të diellit

iu duk sikur pa

fushat e gjera me lule,

lisat e gjatë hijerëndë,

balashin që gardhit i binte me brirë,

shamizezën, flokëthinjurën nënë...

— Eeeeej! Mbeçë, shokë, mbeçë,

përtej Urës së Qabesë!

...Sulltani shtrihej në Stamboll,

mes sixhadesë...

Dergjej në qilimin e verdhë të rërës

nizami shqiptar,

përtej Urës së Qabesë...

## VITET E PARA

Mirë nuk dinim si ndërtoheshin urat,  
shumë s'kishin mbaruar as shkollat e mesme,  
shumë si firmë vinin mollzën e gishtit,  
por kishim besimin tek e nesërmja e ndritur.

Por dinim marksizmin si shkencë,  
se e mësuam mes gjakut dhe borës,  
se e mësuam pranë shokëve të rënë,  
pranë fëmijëve që lindnin maleve të sertë:  
kërthizëprerët me bajonetë!

## VARJA E KOMITIT

Kish dy sy të butë si bari në lëndina,  
që kur egërsoheshin nxirrnin vetëtima.

Mbi supin e fortë qafën ngrinte pushka,  
dita nëpër male, nata nëpër guva.

Por e zun' komitin fshehtas në jatak,  
sytë prej marazit iu rrëmbushën gjak.

Degëve të rrapit lëkundej litari,  
pritëm, zabit, pritëm, sa të ndez cigarin...

Sheshi zhurmëronte, gratë çirrnin faqet,  
burrat përvëlur kafshonin mustaqet.

Dhe ja... krisi dega nga pesha e rëndë,  
ra përdhe opinga, zbathur mbet' një këmbë.

Kjo oping' e dirsur, brenda kishte baltë,  
brenda baltës zverdhte gruri kokërr artë...

## DITËT MË TË BUKURA

Ditët më të bukura të rinisë sonë  
mos kërkoni t'i gjeni nën kaçube trëndafilash  
dhe as në shëtitjen muzgore,  
nën kore bilbilash.

Ditët më të bukura të rinisë sonë  
do t'i gjeni në vërtitjen kolosale të turbinave,  
në valavitjen e grurit që zverdhon fushës,  
në përgjimin e horizonteve  
nga shënjestra e pushkës...

## PASQYRA E LËNDËS

Ditën që mbusha 20 vjet .....	3
Në muzeumin e MP Brëndëshme .....	5
Duke vështruar telat e tensionit të lartë në veri .....	6
Vezullime mbi metal .....	8
Kur kthehen prej pritës .....	10
Heronjtë .....	12
Ai mbeti në këngë .....	13
Elegji për Liri Geron .....	15
Populli .....	17
Meditim .....	18
Shikoje Linda .....	20
Na ishte dikur... ..	22
Stërlina e shpuar .....	24
Polemikë me dorë .....	26
Një turist .....	27
Udhët tona s'janë paralele .....	29
Copa e bukës .....	31
Naganti .....	32
6 vargje nga një poemë për burokracinë .....	34
Këngë e vjetër korçare për kurbetin dhe dashurinë .....	35

Poezia e vërtetë .....	37
Armiku i klasës .....	38
Meditim rreth emrit «Diella» .....	39
Kështjella e Krujës .....	40
Përtej urës së Qabesë .....	41
Vitet e para .....	43
Varja e komitit .....	44
Ditët më të bukura .....	46